

Skandal/ Teater ne ndeshjen Kastrioti – Bylis

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 30 Nentor 2013 20:06



Ne ndeshjen mes Kastriotit dhe Bylisit eshte luajtur teater dhe jo futboll. Te dyja skuadrat kishin rene dakort per ta fiksuar kete ndeshje qe eshte luajtur ne menyre teatrale. Nuk ka patur te humbur por vetem te fituar ne fushe ndersa humbje mund te kene marre vetem kompanite e basteve. Bylisi ne fund te ndeshjes turpshem ka hapur porten per te lene skuadren e Kastriotit te fitoj me rezultatin 2-1. Krutanet kane marre tre pike te cilat mund ti lene ne ndeshjen e rradhes qe mund te luhet ne Ballsh. Lojtaret kane ditur gjithcka dhe ne fund te ndeshjes kane luajtur mjaft mire skenarin teatral. Albaniasoccer.com denoncon kete shfaqje te turpshme qe duhet denuar nga FSHF apo dhe nga prokuroria.